



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. 206/1 Prot

Shkodër, më 29 . 12 .2023

**KONTRATË SHËRBIMI NR.4
REF-90302-03-17-2021**

**“SHËRBIM I MIRËMBAJTJES SË VARREZAVE PUBLIKE DHE TË
DËSHMORËVE”**

**BASHKIA SHKODËR
DHJETOR 2023**


KONTRATË SUPR
PËNDRIMORË
SHKODËR - ALBANIA

KONTRATË SHËRBIMI NR.4
REF-90302-03-17-2021

“SHËRBIM I MIRËMBAJTJES SË VARREZAVE PUBLIKE DHE TË DËSHMORËVE”

E lidhur sot me datë ____ / ____ /2023, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z.Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar në kete kontrate me Vendim Delegimi nr.325 date 02.10.2023 nga **Z.Onid Bejleri** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

Dhe Operatorit ekonomik” Bashkim Vllaznim”sh.p.k. regjistruar ne regjistrin fillestar me nr. CN-139108-05-08 dhe licence te shoqerise kodi III.7.A nr.LN-4842-04-2018 date 04.04.2018 me vlefshmeri te licences pa afat leshuar nga Ministria e e Financave dhe Ekonomise me seli te shoqerise: Shkoder Rrethina GOLEM Rruga Nationale Shkoder-Grude e Re, nr pasurie 254/1, zona kadastrale 1869, Vorrezat Publike Stom Golem me **NUIS K 86713016 K**, e perfaqesuar nga Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise **z.Agim Tahiri** me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkoder për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **”Kontraktuesi”**.

Neni 1

Baza ligjore


- a. Kodi Civil ligji nr.7850, dt. 29.07.1994, i ndryshuar,
- b. Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 52 të ligjit.
- c. VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 59, nenit 60, pika 1/a) e nenit 64, nenit 65 të kreu VI.
- d. Ligji nr.48/2014 ”Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar.
- e. Ligji nr. 9220 dt.15.4.2004, “Mbi shërbimin publik të varrimit”
- f. VKM 712 datë 29.10.2014 ”Për miratimin e rregullores së funksionimit të varrezave”.
- g. Marreveshjes kuader nr.4219 prot date 30.04.2021

Neni 2

Objekti i kontratës

- 2.1. Objekt i kësaj kontrate është shërbimi me objekt: **“Shërbim i mirëmbajtjes së Varrezave Publike dhe të Dëshmorëve”** në përputhje me të gjitha specifikimet

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkoder, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al





teknike të dhena në dokumentat e tenderit dhe që **Kontraktuesi–"Bashkim Vllaznim"sh.p.k** pranon t'i realizojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit.

Neni 3

Vlefëta e kontratës

- 3.1. Kontraktuesi merr përsiper të kryeje të gjitha shërbimet tek Autoriteti Kontraktor sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlere prej **4,916,286** (Katërmilion e nentëqind e gjashtëmbëdhjetemije e dyqind e tetëdhjete e gjashtë)leke pa tvsh dhe **5,899,543.2**(Pesemilion e teteqind e nentëdhjete e nentemije e peseqind e dyzet e tre pike dy)leke me tvsh.
- 3.2. Financimi realizohet nga Buxheti i Bashkise Shkoder.
- 3.3. Çmimet e kontraktorit për shërbimet e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.
- 3.4. Bazuar ne VKM nr.914 dt.29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, kreu II, neni 9, pika 2, Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar.

Neni 4

Afati i kontratës

- 4.1 Kontrata do të realizohet nga data **01.01.2024** deri me **15.05.2024**.

Neni 5

Gjuha e kontratës

- 5.1 Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

Neni 6

Qëllimi

- 6.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 6.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojë mbi KPK.



Neni 7


Përkufizime

- 7.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit me objekt: **Mirëmbajtje varreza publike dhe të dëshmorëve në Qytet dhe në NjA** duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 7.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- 7.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës. “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 7.4 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 7.5 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 7.6 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 7.7 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- 7.8 “Preventivi” quhen vëllimet e punës të plotësuara me cmime, pjesë perberese e kontratës.
- 7.9 “Situacioni” quhet dokumenti i evidentimit faktik të situatës së punës së kryer në përputhje me zerat e punimeve të përcaktuara në kontratë (volumet),
- 7.10 “Vlera totale e kontratës” quhet shumatorja në përputhje me preventivat e punimeve pjesë perberese të kësaj kontrate duke përfshirë dhe rishikimin e cmimit në përputhje me inflacionin e deklaruar.
- 7.11 “Supervizori” quhet personi kompetent i emëruar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkoder i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e realizimit të shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave dhe administrimit të kontratës.
- 7.12 “Drejtori Teknik i Shërbimit të Mirëmbajtjes së Varrezave” është personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Shkodrës, përfaqësues i Kontraktuesit, përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të Mirëmbajtjes së Varrezave.

Neni 8

Preventivi i Punimeve.

- 8.1 Vlerësimi i zerave të punës do të kryhet në bazë të cmimeve të preventivit të ofertës të paraqitur në tender nga Kontraktuesi për Mirëmbajtje e varrezave publike dhe të



dëshmorëve në Qytet per volumet e percaktuara si me poshte:

Preventiv
Periudha: 01 janar-15 maj 2024

Nr	Analiz	Emertimi i sherbimeve	Njesi	Sasi	Çmimi	Vlera
A		Varrezat Publike				
1	An-1	Mirembajtje parcelash dhe rrugeve ne parcela	m2	90180	45,2	4076136
2	Eksp	Mbjellje bordure te gjelbert ne parcela te reja	ml	193	1400	270200
3	An.167	Mbjellje drure dekorative(selvi) ne parcelat e reja	cope	55	3902	214610
4	An.168	F.V.Shkurre dekorative	cope	17	1014	17238
5	Eksp.	Mirembajtje rruge dhe sheshe,asfaltim	m2	41	1750	71750
6	Eksp.	Transport mbeturinash 17km	ton	118	1339	158002
7		Shuma A				4,807,936
B		Varrezat e deshmoreve				
8	2.399	Lyerje me gelqere 2 here ne vite	m2	950	45	42750
9	Eksp.	Pastrim,heqje barnash,riparime suvatimi	m2	1400	25	35000
10	Eksp.	Mirembajtje varresh nga amortizimi,rifreskim germash	cope	34	900	30600
11		Shuma B	lek			108,350
		Shuma A+B	lek			4,916,286
		TVSH 20%				983257
		Totali :	lek			5,899,543.2

Neni 9


Hartimi i Kontratës

- 9.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbeje per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 9.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 10

Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 10.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 10.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.


KONTRATIMI SUBJEKTI
DASHKODER - RREZANJA

10.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.



Neni 11

Informacioni Konfidencial

- 11.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 11.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 10.1 më sipër.

Neni 12

Prona Intelektuale

- 12.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 12.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 12.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 12.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 13

Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 13.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet sipas përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 13.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.



13.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

13.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 14

Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 14.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References ne baze te “Rregullores se funksionimit te Varrezave Publike“.
- 14.2 Kontraktuesi duhet t’i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 14.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.
- 14.4 Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë raporte mujore dhe vjetore ne te cilat duhet të parashikojë listen dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe paisjeve të cilat perdoren per proceset e shërbimeve sipas preventivit ne perputhje me Specifikimet teknike. Ne raporte duhet të paraqiten dhe emrat dhe titujt e personelit mbikqyres te vendosur nga Kontraktuesi, nje permbledhje te te gjitha rasteve te demtimeve te prones private dhe publike, demtime fizike, te cilat jane shkaktuar gjate kryerjes se veprimtarise se percaktuar ne kontrate si dhe nje permbledhje te te gjitha situacioneve te cilat ja percjell Kontraktuesit gjate kesaj kohe.
- 14.5 Kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Shkoder 5 kopje te raportit vjetor brenda 5 diteve nga perfundimi i kontrates te shoqeruar me situacionin e fundit te shërbimit.
- 14.6 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë rakordimin për situacionin e muajit paraardhës. Kontraktuesi pas rakordimit brenda 5 (pesë) ditëve i dorëzon Autoritetit Kontraktor situacionin dhe faturën tatimore elektronike për situacionin mujor të rakorduar sipas volumit të shërbimeve të kryera për muajin paraardhës dhe dokumentacionin përkatës. Situacionet duhet të firmosen nga të dyja Palët në 6 (gjashtë) kopje, dy prej të cilave i jepen Kontraktuesit.
- 14.7 Fatura nuk bëhet në asnjë rast përpara rakordimit dhe nënshkrimit të situacionit. Kërkesa për pagesë duhet të shoqërohet me faturën tatimore elektronike dhe situacionin e rakorduar për muajin paraardhës. Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër përmes postës, ose përmes dorëzimit pranë sekretarisë/zyrës së protokollit së Autoritetit Kontraktor ndersa fatura tatimore ne format elektronik.
- 14.8 Kontraktuesi duhet të mbajnë të dhëna ditore në lidhje me elementet e grafikeve të proceseve të punës dhe duhet t’i raportojë ato çdo muaj me shkrim tek supervizori:

- Lista e punëtorëve dhe orët e punës;
- Rakordimi i grafikeve mujore per proceset e punes.
- Mbi bazen e ketyre grafikeve , jep vleren ne leke per hartimin e situacioneve mujore,
- Komete/vërejtje për kërkesat e Bashkisë ose supervisorit në lidhje me mungesën e cilësisë dhe sasisë.

Neni 15

Specifikime dhe Skicime

- 15.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatiti të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.
- 15.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjënjëse përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

A-Specifikimet e proceseve te punës.


1. Mirëmbajtje parcelash të varrezave publike.

Shërbimet do të realizohen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 90180 m2 nga të cilat 77668 m2 nga sipërfaqja ekzistuese dhe 12512 m2 të shtuar për mirëmbajtje pas ndërtimit të parcelave të reja të përfunduara.

Në këtë zë preventivi janë përfshirë këto punime dhe shërbime:

- Pastrimi i parcelave me sipërfaqe të gjelbër 14 herë në vit me fshesë, heqja e të gjitha mbetjeve dhe evadimi i tyre.
- Pastrimi i barit në rrugët e brendshme anash bordurave 5 herë në vit mbas kositjes së barit, kryesisht në periudhën Pranverë-Vjeshtë.
- Krasitje e drurëve, shkurreve dekorative si dhe punimi i tokes përreth tyre dy herë në vit.
- Krasitja e bordurave të gjelbra (rozmarinë dhe levantinë) 4 herë në vit duke iu dhënë format dekorative.
- Lyerja me gëlqere e të gjitha bordurave të rrugës dhe të varrezave provizore 2 herë në vit në periudhat fillim të pranverës si dhe në fillim të vjeshtës.
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e territorit të varrezave publike dhe të dëshmorëve gjatë gjithë kohës do të realizohet me 10 punonjës nga të cilët tre për varrezat e dëshmorëve, gjashtë për varrezat publike dhe një është për të zëvendësuar punonjësit e tjerë në ditë festash, pushime, raporte mjekësore etj.
- Në bazë të VKM n.r 712, datë 29.10.2014 « Për miratimin e rregullores së funksionimit të varrezave », një ndër kerkesat kryesore është dhe ndricimi i ambienteve natën. Meqenëse janë bërë instalimet 20 prozhektorë 100W është parashikuar pagesa e konsumit të energjisë elektrike.

The block contains a handwritten signature in blue ink over a circular stamp. The stamp text is partially obscured but includes 'BASHKIA E SHKODËR' and 'SHKODËR - ALBANIA'.

- 
- Duke marrë në konsideratë mbjelljet e përvitshme të drurëve dekorative (selvi) dhe bordura të gjelbra, është parashikuar shërbimi i domosdoshem ndaj tyre me procesin e ujitjes.

2. Mbjellja e bordurave të gjelbra në parcelat e reja.

Në çdo vit plotësohen 2 parcela me varre provizore. Në preventiv është llogaritur që çdo vit këto parcela të plotësohen me 243 ml bordurë të gjelbër të llojit levantinë dhe rozmarinë duke plotësuar parcelat me të gjithë elementët e saj.

3. Mbjellje drurë dekorativ (selvi)

Krahas mbjelljeve me bordura të gjelbra në këto parcela, janë planifikuar të mbillen çdo vit edhe 75 copë drurë (selvi) të reja. Po ashtu të kryhet edhe ndonjë zëvendësim i ri në parcelat e vjetra nga tharjet apo dëmtimet.

4. Mbjellje shkurre dekorative.

Njëkohësisht për të patur një harmonizim të dekorit të lartë dhe të ulët të gjelbërt, pemëve dhe bordurave, do të realizohet një kombinim dhe me mbjelljen e 37 copë shkurre dekorative të llojit liguster.

5. Mirëmbajtje rrugë dhe sheshe, asfaltim.

Në këtë zë pune përfshihen riparimet e rrugëve dhe shesheve të dëmtuara në varreza, ku si procese pune do realizohen: prerja e sipërfaqes që do riparohet, shtresë stabilizanti dhe shtresë asfalto betoni me zall lavatrice.

6. Transporti i mbeturinave.

Në këtë proces pune përfshihet grumbullimi i të gjitha mbetjeve që dalin nga pastrimi i varrezave, më pas transportimin e tyre në landfillin Bushat dhe pagesa e depozitimit nga vetë sipërmarrësi. Sasia e mbetjeve është parashikuar mesatarisht 12.5 ton mbetje të ndryshme në muaj.

7. Mirëmbajtja e varrezave të Dëshmorëve.

Shërbimi i mirëmbajtjes në varrezat e Dëshmorëve, konsiston në mirëmbajtjen e territorit dhe ruajtjen e tij me punonjës. Shërbimet kryesore janë pastrimi i sipërfaqes, heqje barnash të këqia, lyerja me gëlqere, riparime suvatimi etj.


C. Shërbimi i varrimit, në varrezat publike.

Shërbimi i Varrimit do të kryhet nga sipërmarrësi i mirëmbajtjes së varrezave sipas preventivave të hartuara nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës.

Shërbimit të varrimit përfshin:

Hapje dhe mbyllje varri, përgatitje vendosje varri hermetik, përgatitje vendosje varri provizor,

Për mirëmbajtjen e varrezave dhe shërbimin publik të varrimit do të zbatohen edhe kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 9220 dt.15.4.2004, "Mbi shërbimin publik të



SHKODËR - ALBANIA

varrimit, në V.K.M. nr.711 dt. 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores Per administrimin dhe funksionimin e varrezave ne territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe në V.K.M. nr.712 dt.29.10.2014 “Per miratimin e rregullores teknike, ”Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

-Dimensionet e pllakave b/a për varret hermetik dhe provizorë, për të rritur dhe të vegjël, janë paraqitur në dokumentacionin bashkëlidhur.

Kosto e shërbimit të varrimit paguhet nga qytetari që i realizohet shërbimi për varrosjen e të afërmit.

Neni 16

Lejet dhe Liçensat

- 16.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 17

Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 17.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Shkodër, përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç propozohet në ofertën e Kontraktuesit.
- 17.2 Kontraktuesi zëvendëson çdo punonjës, nëse Autoriteti Kontraktues Bashkia Shkodër evidenton se personi ka kryer veprime të kundërligjshme ose Autoriteti Kontraktues vlerëson se performanca e personelit është e pakënaqshme.
- 17.3 Nëse lind nevoja për zëvendësimin e një apo më shumë personave që bëjnë pjesë në personelin kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë që zëvendësuesi është me kualifikime ekuivalente ose më të mira. Kontraktuesi duhet të dorëzojë për miratim CV e zëvendësimit.
- 17.4 Kontraktuesi duhet të paguaje çdo kosto shtesë në rast të zëvendësimit të personelit të tij, me përjashtim të rasteve kur shkak i zëvendësimit ka ardhur si përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues, jashtë kontrollit të Kontraktuesit.
- 17.5 Kontraktuesi duhet të sigurojë që pagat e punonjësve të tij janë në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- 17.6 Kontraktuesi duhet te pajise te gjithe punonjesit me uniforma dhe me shenja dalluese te kompanise.
- 17.7 Kontraktuesi eshte i detyruar te caktojë Drejtorin teknik. Drejtori teknik eshte personi qe Kontraktuesi ka percaktuar ne oferten e tij. Drejtuesi Teknik i Punimeve te objektit eshte: **Ing. Erjon Lala**.
zyrfinance@gmail.com
- Detyrat e Drejtorit Teknik te Punimeve jane si me poshte:
- Zbatimin e shërbimit të mirembajtjes së varrezave konform kontrates.
 - Mbajtjen e dokumentacionit teknik të detyrueshëm.



- iii. Ndjekjen e performancës së mirembajtjes së varrezave në përputhje me plan-organizimin e miratuar dhe grafikun e shërbimit
 - iv. Do të jete përgjegjës në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 17.8 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik i shërbimit, Kontraktuesi duhet të lajmërojë me shkrim Autoritetin Kontraktor dhe të ndjeke procedurën e parashikuar në pikën 3 të këtij.
- 17.9 Drejtuesi i ri Teknik duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin Teknik. Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlerëson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e Tenderit. Në këtë rast Kontraktuesi duhet të propozojë dhe caktojë një Drejtues Teknik tjetër pas marrjes së miratimit të nevojshëm nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 18

Vendndodhja

- 18.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar në kontratë.
- 18.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 19

Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 19.1 Kontraktuesi duhet të garantojë me Policë për sigurimin e përgjegjësisë profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin, për ta zhdëmtuar Autoritetin Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e shërbimeve.
- 19.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e shërbimeve që po sigurohen.
- 19.3 Kontraktuesi duhet të sigurohet pranë një shoqërie sigurimi me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës deri në datën e përfundimit të plotë të shërbimit të pastrimit. Sigurimi do të kryhet për humbje ose dëmtim të pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të pronave dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 19.4 Rregulloret për certifikatat e siguracionit do t'i dorëzohen mbikqyrësit për aprovim brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës. Siguracioni duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktuesi nuk siguron certifikatat e kërkuara të siguracionit, kontrata konsiderohet e anuluar. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zëvendësojë, të zgjasë periudhën e paraqitjes së certifikatave të siguracionit ose të kryejë vetë pagesën për policën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale dhe të zbrisë koston e saj nga pagesa që i detyrohet Kontraktuesit.

- 19.5 Ndryshime në afatet e siguracionit nuk mund të bëhen pa aprovimin me shkrim të Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Shkodër.

Neni 20

Çmimi i Kontratës

- 20.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 21

Afatet e Pagesës

- 21.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 21.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 21.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 21.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 21.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 22

Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 22.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 22.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.


Neni 23

Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 23.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e

H. KUFUJI
BASHKIJA - VLLAZNIA
SHKODË





kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 24

Forca Madhore

- 24.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 24.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 24.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 25

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 25.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 25.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 25.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t’i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 25.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 25.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.



Neni 26

Ndalesat, Penalitete dhe Gjobat

- 26.1 **Penaliteti 1 për “Mirembajtjen e parcelave dhe e rrugeve mbrenda parcelave”.**
Qëllimi: Që proceset e punes te realizohen ne kohen e duhur
Përgjegjësia: kompania duhet të realizoje cdo process pune te mirembajtjes sipas grafikut mujor te miratuar.
Kontrolli: Verifikohet realizimi I proceseve te punes te percaktuar ne grafik.
Penaliteti: Per cdo process pune te planifikuar dhe te njesuar me cmim, penaliteti eshte 10 here cmimi perkates I procesit
- 26.2 **Penaliteti 2, per “Mirembajtjen e varrezave te deshmoreve**
Qëllimi: Që proceset e punes te realizohen ne kohen e duhur
Përgjegjësia: kompania duhet të realizoje cdo proces pune te mirembajtjes sipas grafikut mujor te miratuar.
Kontrolli: Verifikohet realizimi I proceseve te punes te percaktuar ne grafik.
Penaliteti: Per cdo process pune te planifikuar dhe te njesuar me cmim penaliteti eshte 10 here cmimi perkates I procesit
- 26.4 **Penaliteti 3, për mbjelljen e bordurave te gjelberta dhe drureve dekorative.**
Qëllimi: Që proceset e punes te realizohen ne kohen e duhur.
Përgjegjësia: kompania duhet të realizoje mbjelljen sipas grafikut mujor te miratuar.
Kontrolli: Verifikohet realizimi I proceseve te punes te percaktuar ne grafik.
Penaliteti: Per mos mbjellje , penaliteti eshte 10 here cmimi perkates I mbjelljes
- 26.5 **Penaliteti 4, per Proceset e tjera te punes sipas zerave te preventivit**
Qëllimi: Që proceset e punes te realizohen ne kohen e duhur
Përgjegjësia: kompania duhet të realizoje cdo proces pune sipas grafikut mujor te miratuar.
Kontrolli: Verifikohet realizimi I proceseve te punes te percaktuar ne grafik.
Penaliteti: Per cdo process pune te planifikuar dhe te perealizuar, penaliteti eshte 10 here cmimi perkates I procesit.
- 26.6 **Penaliteti 5 per Parapregaditjet per varrim.**
Qëllimi: Që te kete elemente te gatshem parafabrikat dhe gropat per sherbimin e varrimit.
Përgjegjësia: Kompania duhet të kete minimalisht ne gjendje ditore ,elemente te gatshem parafabrikat per dyfishen e mesatares se varrimeve ditore.
Njekohesisht kjo e shoqeruar dhe me gropat e varreve
Kontrolli: Verifikohet qe kjo sasi ne cdo moment eshte e gatshme
Penaliteti: Per mos realizim te ketij kushti, penaliteti eshte 10 here cmimi perkates I sherbimit.

Neni 27

Negociatat dhe Amendamentet

- SHKODËR
- 27.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 27.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 27.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 28

Ndryshimi i Porosisë

- 28.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 29

Ndërprerja për Mosplotësim

- 29.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 29.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 30

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit


- 30.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.
- 30.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 31

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- 31.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 31.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 31.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për

kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.



Neni 32

Nënkontrata

- 32.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë
- 32.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 32.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejte të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.
- 32.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nënkontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të japë me nënsipermarrje.
- 32.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 33

Transferimi i të Drejtave

- 33.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratësme përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 34

Sigurimi i Kontrates

- 34.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar.
- 34.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 34.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 35

Siguracioni i Punonjesve

- 35.1 Kontraktuesi përgjigjet për punësimin dhe sigurimin e nepunesve dhe punetoreve, sipas legjislacionit në fuqi. Kontraktuesi duhet të ketë të siguruar

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



nje numer punonjesish jo me te vogel se numri i punonjesve te deklaruar ne oferte. Kontraktuesi duhet ti paraqese Autoritetit kontraktor, cdo 6 (gjashte) muaj, me 10 janar, 10 korrik listen e te gjithë punjesve te siguruar si dhe cdo informacion tjetër ne lidhje me punonjesit e shoqerise .

Neni 36
Baza Ligjore

36.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 37
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 37.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 37.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 38
Mbikqyrja e shërbimit

38.1 Bashkia Shkodër realizon mbikqyrjen e mirmbajtjes të varrezave në territorin e Bashkisë Shkodër përmes procesit të monitorimit të shërbimit të mirembajtjes të varrezave me anë të specialistit pranë drejtorisë të shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës. Grupi i monitorimit në bashki ka përgjegjësi për monitorimin e realizimit të shërbimeve sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Monitorimi dhe mbikqyrja do realizohet sipas detyrave përcaktuar si më poshtë:

- a) Specialistët monitorojnë dhe raportojnë në njësinë e monitorimit të shërbimeve publike/ drejtoria e shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës për zbatimin e shërbimeve sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor
- b) Njësia e monitorimit të shërbimeve publike/drejtoria e shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës mbledh informacionin sipas monitorimit në terren I përpunon ato dhe informon Kontraktorin për shërbimin e munguar sipas grafikëve të shërbimit miratuar nga AK:
- c) Propozon AK për miratim detyra shtesë për ndërhyrje në sipërfaqet e varrezave nën administrimin e Bashkisë Shkodër
- d) Mbikqyrësi i njësië (specialisti) ndjek zbatimin e kontratës, verifikon volumet e punës dhe i paraqet pranë njësisë të monitorimit/drejtorisë të shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës, si edhe bën propozimin për ndalesa dhe penalitete;
- e) Për problematikat e shfaqura kontakton me operatorin për marrjen e masave të menjëherëshme për kryerjen e shërbimit të munguar sipas grafikut;

- f) Në fund të çdo muaji harton proces-verbalin për mbylljen e situacionit të punimeve, duke raportuar punët e kryera apo penalitetet e proceseve të punës të përfunduar
- g) Harton grafikët vjetor të cilët kanë të shprehur frekuencën e proceseve të punës që kryhen mbrenda muajit, mbi bazën e të cilit do të përcatohet vlera e saktë e situacionit mujor. Në rast ndryshimesh gjatë zbatimit të kontratës harton grafikët mujor dhe i paraqet për miratim AK, duke njoftuar me shkrim më pas operatorin sipërmarrës.

Neni 39

Përfaqësimi i Palëve

39.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

- a) Struktura përgjegjëse, në emër të **Autoritetit Kontraktor** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të jetë

Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës
cel/tel/fax _____

E-mail: sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al

- b) Personi që do të jetë përgjegjës në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të jetë **z. Agim Tahiri**.

cel/tel/fax: 0692073175

E-mail: zyrfinance@gmail.com

39.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

39.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit

39.4 Administratori i Kontrates ve në dijeni Titullarin e Autoritetit Kontraktor për çdo rast e çështje dhe nuk mund t'i drejtohet Kontraktuesit pa marrë me parë miratimin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

39.5 Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XIII, neni 107, pika 6, "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, **Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës** si struktura që do të jetë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për

likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

39.6 Personi përgjegjës duhet të ndjekë me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

- a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
- b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
- c) administroh dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
- d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
- dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
- e) administroh kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

Neni 40

Lajmërimet

40.1 Menyra e komunikimit midis Autoritetit Kontraktor Bashkise Shkoder dhe Kontraktuesit do te jete me shkrim ose ne menyre elektronike. Te gjitha njoftimet te cilat palet do ti drejtojne njeri tjetrit duhet te hartohen me shkrim dhe te dorezohen personalisht, me poste zyrtare ose poste elektronike duke iu adresuar paleve ne menyren e meposhtme:

a. Per perfaqesuesin e Autoritetit Kontraktor Bashkise se Shkoder adresa e plote e Institucionit ose adresa e postes elektronike

sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al

b. Per perfaqesuesin e kontraktuesit, adresa e plote e kontraktuesit ose adresa e postes elektronike te cilat palet ne cdo kohe ia kornunikojne njeri tjetrit me shkrim

zyrfinance@gmail.com

40.2 Njoftimet do te kene efekte me marrjen ne dorezim nga palet.

Neni 41

Llogaritja e Afateve



41.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Neni 42

Vlefshmeria e kontratës

42.1 -Kjo kontratë u hartua ne gjashtë kopje origjinale, pese per Autoritetin Kontraktor dhe nje per Kontraktuesin, dhe pasi u lexua, firmoset rregullisht nga palet

42.2-Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

KUSHTET E VEÇANTA

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1

Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është Kontraktor Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga Kryetar i saj **Z.Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nr.325 date 02.10.2023 nga **Z.Onid Bejleri** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

1.2 Kontraktori eshte " **Bashkim Vllaznim**"sh.p.k. regjistruar ne regjistrin fillestar me nr. CN-139108-05-08 dhe licence te shoqerise kodi III.7.A nr.LN-4842-04-2018 date 04.04.2018 me vlefshmeri te licences pa afat leshuar nga Ministria e e Financave dhe Ekonomise me seli te shoqerise: Shkoder Rrethina GOLEM Rruga Nationale Shkoder-Grude e Re, nr pasurie 254/1, zona kadastrale 1869, Vorrezat Publike Stom Golem me NUIS **K 86713016 K**, e perfaqesuar nga Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise **z.Agim Tahiri** me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkoder për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet "Kontraktuesi".

Neni 2

Sigurimi i Kontrates

2.1 Sigurimi i Kontrates në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) **Nuk Ka**.

Neni 3

Fillimi i Zbatimit

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë në datën **01.01.2024** deri me **15.05.2024**

Neni 4

Vendndodhja e Shërbimeve

4.1 Shërbimet do të kryhen në varrezat publike dhe te deshmoreve te qytetit sipas përcaktimeve në raportin teknik.


BASHKIA SHKODËR
BASHKIM VLLAZNIM



Neni 5

Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

5.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

- Personin përgjegjës/supervizorin për ndjekjen e shërbimit.
- Specifikimet teknike
- Grafikun e shërbimit

Neni 6

Kërkesat e Raportimit

6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: Në përputhje me grafikun e shërbimit.

Neni 7

Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej: **Nuk ka**

- a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve.
- b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve:.
- c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve.
- d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier:.

Neni 8

Kushtet e Pagesës

- 8.1 Pagesa për shërbimet, do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të situacionit mujor të shërbimit
- 8.2 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për pagesën në afat të shërbimeve të kryera. Pagesa do të kryhet në bazë të situacionit mujor të paraqitur nga Kontraktuesi me vlerë sipas vëllimeve të kryera, duke u zbritur masa e vëllimeve të shërbimit të pakryer si dhe penaltetë e mbajtura për punë të pakryer. Në situacion duhet të përfshihet vlera e T.V.SH.
- 8.3 Koha e përcaktuar për të përmbushur detyrat deri në njoftimin e operatorit të shërbimit të varrezave dhe dorëzimi i dokumentacionit nga ana e këtij të fundit është data 03-05 të çdo muaji. Në rast mos rakordimi për situacionin e shërbimit mujor ose dokumentacionin mbështetës ku si rrjedhojë sjell vonesa në zbatim të këtij afati, komunikimi midis palëve realizohet me shkrim dhe afati nis ditën kur të dy palët bien dakord.
- 8.4 Supervizori/Administratori i Kontrates bën miratimin e pagesës vetëm në rast se është plotësuar dokumentacioni i mëposhtëm:
Faturën/at tatimore të shërbimit, lëshuar nga Kontraktuesi e cila dorëzohet në formë elektronike



Situacionin te firmosur nga supervizori i sherbimit

(1 Original)

Proces-verbalin e marrjes në dorëzim të shërbimit

(1 Original)

Monedha e pageses do te jete: LEKE.

- 8.5 Ne rast ndryshimi te llogarise nga ana e Kontraktuesit ky i fundit eshte i detyruar te njoftoje paraprakisht Autoritetin Kontraktues, Bashkine Shkoder.

Neni 9

Pagesa Paraprake

- 9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë (nuk ka) .Nëse nuk është specifikuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda (nuk ka) ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.
- 9.3 Në se jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme:Nuk ka

Neni 10

Shërbimet në Lidhje me to

- 10.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së Shërbimeve të Lidhura

Neni 11

Zbritja e garancisë së kontratës

- 11.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë.Nuk parashikohet zbritje e garancise se kontrates.
Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR

BASHKIA SHKODËR

Kryetar i Bashkisë

Benet BECI

Perfaqesuar me vendim delegimi

ZV.Kryetar i Bashkisë

Onid BEJLERI



PER OPERATORIN EKONOMIK

” Bashkim Vllaznim” sh.p.k.

Administrator ligjor

Agim Tahiri